



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

# RREGULLORE DISIPLINORE E FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Prishtinë, shtator 2008

Kosovo Basketball Federation, Lagjja Arbëria, Objekti C2/11, Lokali nr. 4, 10000, Prishtina, Kosovo  
[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com), email: [info@basketbolli.com](mailto:info@basketbolli.com), tel: +381 38 704 101; mob: +386 49 738 080



BNP PARIBAS JOINT VENTURE

TEB



Në bazë të nenit 21, alineja 4 të Statutit të FBK, Kuvendi i Federatës së Basketbollit të Kosovës, në seancën e mbajtur më 06.09. 2008, bie këtë:

## **RREGULLORE DISIPLINORE TË FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS**

### **Neni 1**

Rregullorja disiplinore e Federatës së Basketbollit të Kosovës (në tekstin e mëtejme rregullorja) përcakton kundërvajtjet, përgjegjësitë, dënimet dhe procedurat për shqiptimin e tyre, si dhe çështjet tjera në rastet e mosrespektimit të akteve normative dhe vendimeve të organeve të organizatës së basketbollit.

Federata e Basketbollit të Kosovës (në tekstin e mëtejme FBK) mundet me aktet e veta normative të përcaktojë edhe kundërvajtje tjera dhe përshkruaj dënime për ato kundërvajtje të parapara me rregulloren e Federatës ndërkombëtare të basketbollit (FIBA) për shkeljet e akteve normative të cilat i ka miratuar FBK.

### **Neni 2**

Me propozicionet e garave mund të përcaktohen edhe kundërvajtje tjera të parapara me rregulloren disiplinore të FIBA, gjegjësisht të FBK në lidhje me garat përkatëse.

### **Neni 3**

Klubet me aktet e tyre i përcaktojnë çështjet e përgjegjësisë disiplinore për thyerjen e disiplinës në klub. Përgjegjësia për thyerje të disiplinës së klubit nuk e përjashton përgjegjësinë disiplinore sipas kësaj rregulloreje dhe anasjelltas.

Dënimet disiplinore të shqiptuara sipas akteve normative të klubit veprojnë vetëm në kuadër të klubit, përveç nëse nuk është parapare ndryshe me aktet normative të FBK.

### **Neni 4**

Organet disiplinore të FBK zhvillojnë procedure disiplinore për kundërvajtjet e bëra nga ana e anëtareve të saj dhe organizatave të bashkuara në FBK, për kundërvajtjet e shkaktuara në garat me të cilat udhëheq FBK (nëse nuk është parapare ndryshe me akt të veçantë), për kundërvajtjet e shkaktuara nga delegatet e FBK, në organizata tjera të sportit.

### **Neni 5**

Anëtarit të organizatës së basketbollit nuk mund t'i shqiptohet dënimi për kundërvajtje të cilën e ka bërë para se të përcaktohet me këtë rregullore dhe nuk ka qenë e përcaktuar me ndonjë akt dhe nuk ka qenë i paraparë dënimi.

## **Neni 6**

Askush nuk mund të konsiderohet shkaktar i kundërvajtjes para se kjo të vërtetohet me vendim të plotfuqishëm të organit meritor.

## **Neni 7**

Për kundërvajtjet të cilat i shkaktojnë anëtarët e organizatave të basketbollit, do të dënohen organizatat e basketbollit dhe personat përgjegjës në ato organizata.

Person përgjegjës konsiderohet personi të cilit i është besuar një lëmi e caktuar e punëve dhe detyrave në organizatën e basketbollit.

Për kundërvajtjet që i shkaktojnë anëtarët e klubeve përgjegjësinë e mbajnë klubet.

## **Neni 8**

Organizatat shkaktojnë kundërvajtje nëse deri te kryerja e saj ka ardhur me veprimin ose lëshimin e kryerjes së veprimit nga ana e organit, personit përgjegjës ose personit tjetër i cili ka qenë i autorizuar të përfaqësoj organizatën.

## **Neni 9**

Përgjegjësia e personit përgjegjës qëndron nëse deri te kundërvajtja ka ardhur me veprimin e tij ose lëshimin e kryerjes së veprimit dhe nëse këtë e ka bërë padashur.

Përgjegjësia e personit përgjegjës nuk përfundon me ndërprerjen e anëtarësisë ose funksionit në organizatën e basketbollit.

## **Neni 10**

Kjo rregullore aplikohet pa marrë parasysh se a është bërë kundërvajtja në territorin e Kosovës apo jashtë tij.

## **Neni 11**

Kjo rregullore aplikohet, nëse me akte ndërkombëtare nuk është paraparë ndryshe, edhe për shtetas të jashtëm që cilët janë anëtarë të organizatës së basketbollit.

## **Neni 12**

Mosnjohja e akteve normative nuk e përjashton përgjegjësinë.

## **I.-KUNDËRVAJTJET DISIPLINORE**

### **Neni 13**

Kundërvajtësi është përgjegjës kur kryen kundërvajtje me paramendim,nga pakujdesia ose padashur.

Nuk është kundërvajtje,në kuptim të kësaj rregulloreje,kur është bërë në vetëmbrojtje ose nevojës së patjetërsueshme(të fundit).

### **Neni 14**

Për kundërvajtje përgjigjet kryerësi,nxitësi si dhe ndihmësi i kundërvajtjes së shkaktuar.

### **Neni 15**

Tentimi ndëshkohet vetëm nëse kjo është paraparë me këtë rregullore.

## **II.-DËNIMET**

### **Neni 16**

Kryerësit e kundërvajtjes mund t'i shqiptohen këto dënime:

- vërejtje (publike)
- dënimi me të holla
- ndalesa e pranisë së publikut në numër të caktuar të ndeshjeve
- ndalesa e zhvillimit të numrit të caktuar të ndeshjeve në terren të vet,
- ndalesa për të luajtur ose kryerjes së detyrës në numër të caktuar të ndeshjeve,
- përjashtimi nga garat e mëtejme ose kthimi në rang me të ulët,
- përjashtimi përjetë nga organizata e basketbollit.

### **Neni 17**

Vërejtja shqiptohet për kundërvajtjen e kryer në rrethana lehtësuese,për të cilën parashihet dënimi me ndalesë loje ose kryerjes së detyrës në numër të caktuar të ndeshjeve,kurse organi procedural do ta vlerësoj se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit.

### **Neni 18**

Dënimi me të holla mund të shqiptohet vetëm ndaj kryerësit të kundërvajtjes,i cili në bazë të çfarëdo mënyre realizon kompensim me të holla në lidhje me s portin e basketbollit.

Lartësia e dënimit me të holla për individ mund të jetë prej 10 € deri 3000 €, kurse për klubet prej 10 € deri 5000 €.

Kundërvajtësi është i obliguar që dënimin me të holla ta paguaj në afat prej 8 ditësh nga vendimi i plotfuqishëm, përndryshe do të pezullohet deri sa ta paguaj dënimin me të holla.

Dënimi kohor mbi ndalimin e zhvillimit të ndeshjes ose kryerjes së detyrës mund të shqiptohet, dhe atë në kohëzgjatje prej më së paku tre (3) muaj dhe më së shumti tre (3) vjet.

### **Neni 19**

Dënimi i ndalesës për loje dhe kryerje të detyrës mund të shqiptohet si ndalesë për lojë dhe kryerje të detyrës në numër të caktuar të ndeshjeve, garë atë ndryshme (kampionale, për kupe, miqësore, ndërkombëtare dhe për kombëtare) ose në të gjitha llojet e garave.

Klubi të cilit i është shqiptuar dënimi për ndalesë loje në disa ndeshje në terren të vet mund ti zhvilloj ndeshjet në terren tjetër ku është e regjistruar palestra për stinorin vijues për zhvillimin e ndeshjeve të basketbollit të ligës përkatëse. Largësia minimale e vendit në të cilin mund të zhvillohen ndeshjet mund të përcaktohet me propozicionet e garës përkatëse.

Klubi të cilit i është shqiptuar dënimi ndalesë loje në disa ndeshje pa praninë e publikut, obligohet të siguroj palestrën ashtu që në ndeshje mund të jenë të pranishëm vetëm personat zyrtar dhe përfaqësuesit mjeteve të informimit.

Dënimi ndalesë loje ose kryerje të detyrës shqiptohet në më së paku 2 e më së shumti 8 lojë, kurse për klube nga 1 deri 8 ndeshje mos lojë në terren të vet, ose ndalesa e pranisë së publikut në terren të vet.

### **Neni 20.**

Dënimi kohor për ndalesë loje ose kryerje të detyrës nënkupton ndalesë loje ose kryerje të detyrës në kohë të caktuar.

Dënimi kohor për lojë ose kryerje të detyrës mund të shqiptohet si ndalesë për të gjitha ndeshjet, të të gjitha llojeve të garave, ose ndalesë për ndeshje të llojeve të ndryshme të garave ose kryerjes së disa apo të të gjitha detyrave në kohë të caktuar.

Dënimi kohor për ndalesë loje ose kryerje të detyrës shqiptohet për muaj të plotë ose vite të plota.

Ky dënim mund të shqiptohet nga së paku 3 muaj e më së shumti 3 vjet.

Në raste kur ky dënim i shqiptohet kryerësit të kundërvajtjes i cili mban dënimin e mëhershëm mund t'i shqiptohet dënim unik në kohëzgjatje më shumë se 3 vjet, e më së shumti 4 vjet. Në rast se kryerësi pas dënimit të dytë kryen kundërvajtje të re, mund ti shqiptohet dënimi i ndalesës së përjetshme për loje ose kryerje të detyrës.

## **Neni 21**

Dënimi i ndalesës së përgjeshme për lojë ose kryerje të detyrës dhe dënim kthimi në rang më të ulët të garave shqiptohet me rastin e kundërvajtjeve të bëra në rrethana renduese kur kryerësi i kundërvajtjes ka shprehur vendosmëri, qëndrim ose pafytyrësi ose ka shkaktuar pasoja të rënda.

## **Neni 22**

Me rastin e shqiptimit të dënimit, ndalesë kohore për lojë ose kryerje të detyrës dhe dënimit me të holla, organi kompetent mund t'a shtyje kryerjen e dënimit ( dënim me kusht) për kohën e cila nuk mund të jetë më shkurt se 6 muaj, as më gjatë se 6 muaj, as me gjatë se 2 vjet, kështu që dënimi nuk do të kryhet, nëse kryerësi në këtë kohë nuk bën kundërvajtje të re.

Shtyrja e dënimit të shqiptuar do të caktohet nëse në bazë të rrethanave në të cilat është kryer kundërvajtja ose në bazë të sjelljeve të kryerësit, pas kryerjes së veprës, dhe duke pasur parasysh jetën e tij të mëparshme, organi kompetent vlerëson se kryerësi edhe pa shqiptim të dënimit në të ardhmen nuk do të kryej kundërvajtje si dhe vetë shqiptimi i dënimit do të kryej qëllimin e dënimit.

## **III.-MATJA E DËNIMIT**

### **Neni 23**

Me rastin e matjes së dënimit merren parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë që dënimi të jetë më i madh ose më i vogël, veçanërisht pësia e kundërvajtjes dhe pasojat, shkalla e përgjegjësisë e kryerësit, nxitjet e brendshme, rrethanat në të cilat është kryer kundërvajtja, qëllimi i shprehur, vetit morale dhe qëndrimi i kryerësit pas veprimit të bërë.

### **Neni 24**

Rrethanat renduese ekzistojnë kur kundërvajtja është përsëritur, kur ekzistojnë pasoja të rënda ose rrethana tjera nga të cilat kundërvajtja ka marr formë të rëndë-pasoja. Kryerësi është përsëritës nëse më herët ka qenë i dënuar për kundërvajtjen e bërë.

### **Neni 25**

Rrethanat lehtësuese ekzistojnë kur kryerësi para kundërvajtjes së bërë ka qenë shembull i sjelljes sportive, ose ka përvojë (stazh), me pjesëmarrje në kombëtare ose merita dhe mirënjohje tjera për zhvillimin e sportit të basketbollit.

Pranimi i gabimit nga kryerësi, mund të merret si rrethanë lehtësuese.

## **Neni 26**

Ne rastet e matjes së dënimit për më shumë se një kundërvajtje që njëkohësisht vendoset, së pari përcaktohet dënimi për secilën kundërvajtje veç e veç, kurse pastaj vendoset për dënimin e përgjithshëm, dhe atë:

- nëse për një kundërvajtje është përcaktuar dënimi i ndalesës së përjetshme për lojë ose kryerje të detyrës, shqiptohet vetëm ky dënim,
- me shumë dënime kohore për ndalesë loje ose kryerje të detyrës ose dënimi për ndalesë loje ose kryerje të detyrës në më shumë ndeshje, bashkohen në një dënim i cili patjetër duhet të jetë më i vogël se shuma e dënimeve të shqiptuara.
- Nëse për një kundërvajtje shqiptohet dënimi kohor për ndalesë loje ose kryerje të detyrës në numër të caktuar të ndeshjeve, atëherë shqiptohet dënimi kohor për ndalesë loje ose kryerje të detyrës.

## **Neni 27**

Në rastin kur i shqiptohet dënimi kryerësit i cili vuan dënimin, organi kompetent këtë dënim do ta konsideroj të përcaktuar, do të mat dënimin për kundërvajtjen e re, pastaj do të shqiptoj dënimin e përgjithshëm, duke vepruar sipas neneve 20 dhe 26 të kësaj rregulloreje, por që pjesa e mbajtur e dënimit do të llogaritet në dënim si pjesë e dënimit të përgjithshëm.

## **IV.-VJETËRSIMI**

### **Neni 28**

Inicimi i procedurës disiplinore vjetërsohet në kohën prej 6 muajsh, duke llogaritur nga dita kur është bërë kundërvajtja.

Procedura disiplinore nuk mund të zhvillohet nëse në kohëzgjatje prej 6 muajsh nga dita e inicimit të procedurës nuk është marrë vendimi i shkallës së parë.

## **V.-SHUARJA SHLYERJA DHE KRYERJA E DËNIMIT**

### **Neni 29**

Dënimi i shqiptuar nuk mund të kryhet nëse kanë kaluar :

- një vit nga shqiptimi i ndalesës së lojës apo kryerjes së detyrës në numër të caktuar të ndeshjeve,
- dy vite nga shqiptimi i dënimit kohor për ndalesë loje apo kryerjes së detyrës në kohëzgjatje prej një viti,

- tri vite nga shqiptimi i dënimit kohor për ndalesë loje apo kryerje të detyrës,në kohëzgjatje me shumë se një vit,
- Pezullimi i shqiptuar për dënimin me të holla deri në vlerën 500 € vazhdon një vit nga shqiptimi i dënimit me të holla ndërsa mbi vlerën 500 € vazhdon derisa i dënuari nuk e kryen pagesën.

Vjetërsimi i kryerjes së dënimit fillon nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit.

Kryerja e dënimit kohor ose të dënimit me ndalesë loje apo kryerje të detyrës në numër të caktuar të ndeshjeve nuk vlen për kohën e qëndrimit në burg,apo të qëndrimit dhe lojës jashtë Kosovës.

### **Neni 30**

Me kalimin e tri vjetëve nga dita e kryerjes dhe vjetërsimit të dënimit,i dënuari fshihet nga lista e të dënuarve. Dënimi me kusht fshihet nga evidenca me kalimin e një viti nga dita e kalimit te kohës së paraparë për shterje të mbajtjes së dënimit.

## **VI.-EVIDENTIMI I DËNIMIT**

### **Neni 31**

Vendimet e plotfuqishme regjistrohen në evidencën e organit kompetent për shqiptimin e dënimeve të shkalles së parë.

## **VII. -PROCEDURA DISIPLINORE DHE**

### **KOMPETENCAT PËR VENDOSJE**

#### **Neni 32**

Procedura disiplinore iniciohet në bazë të fletëparaqitjes të cilën mund ta paraqes secili anëtar i FBK,person zyrtar,organet apo organizatat e FBK,kundër anëtarit të FBK,delegatëve të kuvendit dhe anëtarëve të bordit të FBK- në organet tjera sportive.

#### **Neni 33**

Me rastin e dorëzimit të fletëparaqitjes,paraqitësi i kërkesës duhet të paguaj në llogari të FBK taksën në shume prej 50 € e cila i kthehet paraqitësit të kërkesës nëse kërkesa është e bazuar. Nëse paraqitësi nuk dëshmon pagesën e taksës,fletëparaqitja nuk do të shqyrtohet.

Taksën nuk e paguajnë personat të cilët parashetrojnë fletëparaqitje sipas detyrës zyrtare.



#### **Neni 34**

Në bazë të kësaj rregulloreje, mund të vendosin këto organe disiplinore:

- Organet e FBK,
- Organet tjera të parapara me akte të veçanta të FBK,

#### **Neni 35**

Në rast se me vendimin përfundimtar të klubeve ose organeve tjera të parapara me akt të veçantë të FBK, është shqiptuar dënimi kohor i ndalesës për lojë ose kryerjes së detyrës, në shkallën tjetër për këtë dënim vendos komisioni disiplinor i FBK.

#### **Neni 36**

Për ankesat në vendimet e komisionit disiplinor të FBK vendos Komisioni Arbitrar i FBK.

#### **Neni 37**

Komisioni disiplinor përbehet prej 3 anëtarëve të cilët i emëron bordi i FBK. Komisioni disiplinor vendos me shumicë votash. Komisionit disiplinor i ndihmojnë bashkëpunëtorët profesional të cilëve u besohet kryerja e disa punëve në procedurën e vendosjes së drejtë.

#### **Neni 38**

Komisioni disiplinor vendos në bazë të procedurës së zbatuar dhe deklaratave të dhëna nga pjesëmarrësit, të cilat mund të jenë në formë të shkruar apo gojore. Në procedurën disiplinore, komisioni disiplinor vlerëson faktet sipas bindjes së lirë.

#### **Neni 39**

Në rast se ekziston dyshimi i bazuar së kundërvajtësi ka kryer kundërvajtje për të cilën mund t'i shqiptohet dënimi kohor i ndalesës për lojë apo për kryerje të detyrës ose dënimi i përjetshëm për lojë ose për kryerjen e detyrës, ose që është kryer kundërvajtje në bazë të nenit 83 të rregullores, mund t'i shqiptohet pezullimi.

Pezullimin e shqipton kryetari i komisionit disiplinor dhe zgjat 7 ditë. Pezullimin mund ta vazhdojë komisioni disiplinor deri në marrjen e vendimit të shkallës së parë, e që mund të vazhdohet deri te plotfuqishmëria e vendimit, përpos në rastin nga neni 18 të kësaj rregulloreje. Koha e kaluar nën pezullim llogaritet në dënim. Për vendimin për pezullimin njoftimi bëhet përmes ueb faqes zyrtare të FBK.

#### **Neni 40**

Në rastin e përjashtimit të lojtarit në lojë, paraqitja nga ana e delegatit apo gjyqtarëve sjell pezullimin e menjëhershëm. Pezullimi i menjëhershëm zgjat më së shumti një lojë.

#### **Neni 41**

Organi disiplinor vendos me vendim të shkruar, i cili përmban :

- emrin dhe përbërjen e organit që vendos, si dhe kohën e marrjes së vendimit,
- emri e mbiemri dhe funksioni i personave, gjegjësisht emërtimin e organit të cilit i shqiptohet dënimi
- vendimi mbi dënimin,
- arsyetimi i vendimit
- këshillë juridike.

#### **Neni 42**

Vendimi përgatitet në ekzemplar të mjaftueshëm për të dënuarin, klubin e tij (nëse është dënuar lojtari) zyrën e FBK dhe paraqitësin e kërkesës.

#### **Neni 43**

Kundër vendimit të komisionit disiplinor të shkallës së parë mund të parashtrohet ankesë në afat prej 3 ditësh, duke llogaritur nga dita e përcjelljes së vendimit, kurse i paraqitet Komisionit Arbitrar. Me rastin e paraqitjes së ankesës, paraqitësi duhet të paguaj në llogari të FBK taksën në shumën prej 300 €, mjete të cilat i kthehen paraqitësit nëse i miratohet ankesa.

Ankesën mund ta bëjë paraqitësi i kërkesës, personi të cilit i është shqiptuar dënimi, klubi i dënuar dhe klubi për lojtarin apo funksionarin e dënuar. Nëse pala e pakënaqur bashkë me ankesën nuk e paraqet edhe dëshminë për taksën e paguar, ankesa nuk do të shqyrtohet.

#### **Neni 44**

Nëse është shqiptuar dënimi i përjetshëm për ndalesë loje apo kryerje të detyrës ose dënimi kohor për ndalesë loje apo kryerje të detyrës më shumë se një vit, kurse vendimi i tillë konfirmohet nga organi gjegjës i shkallës së dytë kundër këtyre vendimeve mund të paraqitet ankesë Kuvendit të FBK në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimin të vendimit të shkallës së dytë përmes organit të shkallës së dytë, por që ankesa nuk e ndalon ekzekutimin.

#### **Neni 45**

Nëse ankesën e ka paraqitur vetëm i dënuari, vendimi i shkallës së parë nuk mund të ndryshohet në dëm të tij. Ankesa e paraqitur ndalon ekzekutimin e vendimit, përpos në rastet e parapara nga neni 44, si dhe paraqitja e ankesës për vendimin mbi pezullim.

## **VIII. -KËSHILLAT JURIDIKE TË JASHTËZAKONSHME**

### **Neni 46**

Përsëritja e procedurës mund të kërkohet:

- nëse ekziston dyshimi i bazuar që vendimi është marrë në bazë të fakteve të rrejshme,
- nëse ekzistojnë faktet dhe dëshmitë e reja të cilat me herët nuk janë ditur, e të cilat do të ndikonin me rastin e vendosjes

### **Neni 47**

Propozimin për përsëritjen e procedurës mund ta paraqesin:

- I dënuari
- Klubi, nëse është dënuar lojtari apo funksionari i tij,
- Paraqitësi i kërkesës.

Propozimi për përsëritjen e procedurës paraqitet në afat prej 6 muaj duke llogaritur nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit. Për propozimin për përsëritjen e procedurës vendos organi të cilit i sulmohet vendimi.

## **KËRKESA PËR MBROJTJEN E LIGJSHMËRISË**

### **Neni 48**

Kundër vendimeve të plotfuqishme të marra në kundërshtim me akteve normative të FBK mund të shtrohet kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë. Për kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë vendos kuvendi i FBK. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqitet në afatin prej 3 muajsh nga plotfuqishmëria e vendimit.

### **Neni 49**

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të refuzohet apo pranohet, me këtë rast vendimi i plotfuqishëm anulohet kurse lënda kthehet në rishqyrtim dhe vendosje.

## **ZBUTJA E JASHTËZAKONSHME E DËNIMIT**

### **Neni 50**

Në bazë të ankesës së të dënuarit, kuvendi FBK mund ta liroj të dënuarin nga vuajtja e mëtejme e dënimit, ose t'ia zbut dënimin në rast se ekzistojnë rrethanat për një vendim të tillë. Me rastin e vendosjes sipas paragrafit paraprak, gjithmonë do të vlerësohet mendimi i organit të shkallës

së parë. Lutja për zbutjen e dënimit mund të bëhet pas kalimit të së paku 6 muajve nga plotfuqishmëria e vendimit për dënim.

Lutja për zbutjen e dënimit,të ndëshkuarit me dënim kohor,ndalesë të përjetshme për loje ose kryerje të detyrës,mund të behet pas kalimit të 3 vjetëve nga plotfuqishmëria e dënimit të shqiptuar.

## **IX.-PJESA E VEÇANTË**

### **Neni 51**

Ai i cili në çfarëdo mënyre nuk i kryen vendimet ose nuk i respekton aktet normative me të cilat rregullohen çështjet me interes të përbashkët të sportit të basketbollit:

- do të dënohet me dënim kohor,ndalesë loje apo kryerje të detyrës deri në 1 (një) vjet,
- nëse kundërvajtjen e bën klubi-ekipi,do të dënohet me të holla,kurse personi përgjegjës i klubit do të dënohet me dënim kohor ndalesë në kryerjen e detyrës deri në një vit.

### **Neni 52**

Klubi i cili i lejon lojtarit shkuarjen jashtë Kosovës pa pëlqimin e FBK,gjegjesisht klubi i cili me marrëveshje shkëput kontratën me lojtarin në kundërshtim me dispozitat e rregullores për regjistrim, kalim dhe të drejte loje të lojtareve,do të dënohet me kthim në rang më të ulët të garave.

### **Neni 53**

Klubi i cili nuk i respekton dinamikën e pagesës së kompensimit klubit tjetër,në bazë të marrëveshjes dypalëshe,e cila duhet të deponohet në FBK,pezullohet deri në kryerjen e obligimeve dhe dënohet me të holla.

### **Neni 54**

Kush nuk i kryen vendimet e organeve të organizatës së basketbollit:

- do të dënohet me dënim kohor,ndalesë loje apo kryerje të detyrës deri në dy vjet,
- nëse kundërvajtjen e bën klubi-ekipi,do të dënohet me të holla,kurse personi përgjegjës i klubit do të dënohet me dënim kohor ndalesë dy vjeçare në kryerjen e detyrës.

### **Neni 55**

Kush vepron direkt apo indirekt kundër vendimeve të organeve të organizatës së basketbollit, ose në mënyrë tjetër rrezikon autoritetin dhe efikasitetin e atyre organeve:

- do të dënohet me dënim kohor të ndalesës për lojë apo të kryerjes së detyrës,

- në rastet më të rënda mund të shqiptohet edhe dënimi i ndalesës së përhjetshme për lojë apo për kryerje të detyrës,

- nëse kundërvajtjen e kryen klubi-ekipi,do të dënohet me të holla,kurse personi përgjegjës me dënim kohor të kryerjes së detyrës,që në raste më të rënda mund të jetë

ndalesë e përhjetshme e kryerjes së detyrës.

#### **Neni 56.**

Ai që i thirrur para organeve të organizatës së basketbollit sillet në mënyrë të pahijshme dhe josportive,ose që pa arsye nuk i përgjigjet ftesës:

- do të dënohet me ndalesë kohore për lojë apo kryerje të detyrës.

#### **Neni 57**

Kush shprehet në mënyrë ofenduese dhe bartë të pavërteta për udhëheqjen e basketbollit,klubit dhe anëtarit të organizatës së basketbollit:

- do të dënohet me ndalesë kohore për lojë apo kryerje të detyrës më se paku 1 vjet,

- nëse këtë e bën klubi-ekipi,dënohet me të holla,kurse personi përgjegjës i klubit do të dënohet me ndalesë kohore të kryerjes së detyrës së paku 1 vit.

#### **Neni 58**

Kush i nxit garuesit ose funksionarët e klubeve për mospjesëmarrje të ekipeve,ose të mos paraqiten në përbërjet me të forta,të mos angazhohen,apo të mos luajnë ashtu siç dinë apo të lëshojnë fushën ose lojën:

- do të dënohen me ndalesë kohore për lojë apo kryerje të detyrës së paku 6 muaj, Kur nxitja ka pasur sukses:

- mund të dënohen me ndalesë të përhjetshme lojë apo kryerje të funksionit, lojtari apo ndonjë anëtar tjetër i klubit që pranon nxitjen nga alineja 1 të këtij neni do të dënohet me ndalesë të përhjetshme për lojë apo kryerje të detyrës,kurse klubi do të kthehet në rang më të ulët të garave.

#### **Neni 59**

Kush nxit me shpërblime-dhurata ose në mënyrë tjetër ndikon tek referat ose delegati që detyrën e vet të mos e kryejnë në frymën e rregullave të basketbollit:

- do të dënohet me ndalesë lojë ose kryerje të detyrës më së paku 1 vit,

Kur nxitja ka pasur sukses mund të dënohet me ndalesë të përhjetshme për lojë apo kryerje të detyrës. Gjyqtari apo delegati që kanë pranuar nxitjen,shpërblimin apo premtimin dhe detyrën e kanë kryer në kundërshtim me rregullat e basketbollit:

- do të dënohen me dënimin e njëjtë.

#### **Neni 60**

Cilido që në çfarëdo mënyre merr pjesë ose ndikon në kurdisje të rezultatit në ndeshje të basketbollit:

- do të dënohet me ndalesë loje apo kryerje të detyrës me së paku 1 vit ose me ndalesë të përjetshme për lojë apo kryerje të detyrës.

Klubi i cili merr pjesë në kurdisje të rezultatit:

- do të dënohet me të holla dhe kthimin në rang më të ulët të garave.

#### **Neni 61**

Klubi i cili nuk i kryen obligimet dhe detyrat ndaj organizatës së basketbollit:

- do të dënohet me të holla.

#### **Neni 62**

Cilido që përmes deklaratave ose formave tjera sjell në lajthitje organet e federatës (trupat ose funksionaret në këto organe) ,dhe përmes kësaj janë marrë vendime të gabuara:

- do të dënohen me ndalesë kohore për lojë kryerje të detyrës .

Nëse këtë kërkesë e bën klubi (nga alineja 1),organi i tij ose funksionari ,klubi do të dënohet me të holla.

#### **Neni 63**

Kush jep dëshmi te rrejshme në procedurë para organeve të organizatës së basketbollit:

- do të dënohet me ndalesë loje apo kryerje të detyrës më së paku 6 muaj,

- nëse veprimin nga alineja 1 të këtij neni e kryen personi përgjegjës i klubit,

- klubi do të dënohet me të holla,kurse personi përgjegjës me ndalesë për kryerjen e detyrës më së paku 6 muaj.

#### **Neni 64**

Cilido që si anëtar i organizatës së basketbollit,sillet në mënyrë të pahijshme në vend publik:

- do të dënohet me ndalesë loje apo kryerje të detyrës deri në 1 vit,

- cilido që sillet në mënyrë të pahijshme gjatë lojës,kurse nuk është pjesëmarrës në lojë do të dënohet me 1 vit ndalesë loje apo kryerje të detyrës.

### **Neni 65**

Kush fyen,provokon ose fizikisht sulmon garuesin, trajnerin, gjyqtarin, funksionarin, delegatin ose shikuesin në lojë,ose jashtë terrenit të basketbollit:

- do të dënohet më së paku 6 muaj me ndalesë loje apo kryerje të detyrës,posaçërisht në rastet e rënda mund të dënohen me ndalesë loje apo kryerje të detyrës përjetë.

### **Neni 66**

Kush është i dënuar me vendim të plotfuqishëm ose është pezulluar,kurse fshehtas kryen ndonjë detyrë lidhur me sportin e basketbollit:

- do të dënohet me ndalesë loje apo kryerje të funksionit në kohëzgjatje prej një viti,

Me këtë dënim do të dënohen edhe personat përgjegjës që kanë lejuar kryerjen e funksionit në kuptim të kësaj alineje. Nëse funksioni kryhet në klub,klubi do të dënohet me të holla.

### **Neni 67**

Klubi-ekipi i cili gjendet nën pezullim,dhe merr pjesë në ndeshje publike:

- do të dënohet me të holla,kurse personi përgjegjës do të dënohet me dënim kohor në kryerje të detyrës. Ekipi që është pezulluar ose ka në përbërje lojtar që nuk është regjistruar në mënyrë të rregullt,ose nuk është regjistruar,i cili është nën pezullim ose në mbajtje të dënimit,e humb ndeshjen 20:0 dhe nuk merr pikë për lojë. Nëse ekipi dy herë humb në këtë mënyrë kthehet në rang më të ulët të garave.

### **Neni 68**

Klubi i Super Ligës i cili nuk plotëson obligimin që në gara zyrtare të kategorive të reja të merr pjesë më ekipet e juniorëve,kadetëve dhe pionierëve ose i lëshon garat në këto kategori dënohet me të holla :

1.Juniorë 250 €

2.Kadetë 350 €

3.Pionierë 500 €

### **Neni 69**

Klubi organizatori ndeshjes në të cilën ka pasur parregullsi (trazira – përleshje e shikuesve, tentim ose realizim i sulmit fizik ndaj lojtarëve dhe personave tjerë të skuadrës kundërshtarë ose personave zyrtar të ndeshjes pas përfundimit të ndeshjes në brendi ose jashtë palestrës sportive:

- Dënohet me të holla.

Në raste më të rënda (me pasoja lëndimi), Klubi organizator do të dënohet me ndalesën e pranisë së shikuesve me numrin e caktuar të ndeshjeve ose me ndalesë të lojës me disa ndeshje në fushën e vet.

#### **Neni 70**

Klubi-ekipi i cili pa arsye tërhiqet nga garat: do të dënohet me 3000 € dhe me kthim në rang më të ulët të garave se sa ai rang më të cilin do të binte me rënien nga garat të cilat i ka lëshuar

#### **Neni 71**

Klubi i cili me kohë nuk paraqet vendin dhe kohën e zhvillimit të ndeshjes:

- do të dënohet me të holla

#### **Neni 72**

Lojtari i cili përjashtohet për lojë brutale:

- do të dënohet me ndalesë loje me numër të caktuar të ndeshjeve,ose me dënim me të holla.

- Nëse për shkak të kundërvajtjes nga alineja paraprake vjen deri të lëndimi i rënde I lojtarit kundërshtar:

- Do të dënohet me dënim kohor për ndalesë loje.

#### **Neni 73**

Lojtari,funksionari ose trajneri me fajin e të cilit vjen deri te ndërprerja e lojës e cila nuk vazhdohet:

- Dënohet me ndalesë kohore për lojë ose kryerje të detyrës apo me të holla.

#### **Neni 74**

Lojtari apo trajneri që është larguar nga bankina i cili edhe me tej sillet në mënyrë josportive:

- dënohet me ndalesë kohore për lojë ose kryerje të detyrës apo me të holla.

#### **Neni 75**

Lojtari ose trajneri që fizikisht sulmon lojtarin kundërshtar gjatë ndeshjes:

- dënohet me ndalesë loje ose kryerje të detyrës në numër të caktuar të ndeshjeve, apo me të holla,kurse në rastet më të rënda me ndalesë kohore për lojë apo kryerje të detyrës.

#### **Neni 76**

Lojtari,trajneri ose ndonjë anëtar tjetër i organizatës së basketbollit I cili publikisht në mënyre josportive kritikon referat



- do të dënohet me ndalesë loje apo kryerje të detyrës në numër të caktuar të ndeshjeve ose me të holla.

### **Neni 77**

Personi përgjegjës i klubit ose Shkollës së basketbollit i cili parashton shënime të rrejshme ose dokumentin e falsifikuar për regjistrimin e lojtarit të kategorive të reja (junior, kadet dhe pionier), organit të FBK-s për regjistrim:

- Dënohet me përjashtim përjetë në sportin e basketbollit

Në qoftë se konstatohet se një lojtar është regjistruar me shënime të rrejshme ose dokumente të falsifikuara:

Klubit ose Shkollës së basketbollit automatikisht i shlyhen të gjitha rezultatet e arritura, përjashtohet nga gara për vitin garues në vijim dhe edicionin e ardhshëm.

Lojtari i cili është paraqitur për skuadrën në ndeshjet zyrtare të FBK-s, për të cilin është konstatuar se është i regjistruar me shënime të rrejshme ose dokumente të falsifikuara:

Dënohet me tre (3) vjet ndalesë mos lojë.

Trajnerit i cili e aktivizon në skuadër lojtarin e regjistruar me shënime të rrejshme ose dokumente të falsifikuara:

I parashtrohet fletëparaqitja Shoqatës së trajnerëve të FBK-s për marrjen e masave disiplinore.

### **Neni 77/a**

Klubi i cili e ka fituar titullin e kampionit, në cilindo çast kur konstatohet se në skuadër e ka aktivizuar lojtarin e regjistruar me shënime të rrejshme ose dokumente të falsifikuara:

- Dënohet me marrjen e titullit të kampionit.

Ndaj personave përgjegjës inicohet procedurë disiplinore tek organi disiplinor i FBK-s.

### **Neni 78**

Lojtari i cili kalon në klub tjetër pa pëlqimin e klubit të vet:

- do të dënohet me ndalesë kohore për loje,

Klubi i cili pa pëlqim inkuadron në ekip lojtarin nga ekipi tjetër:

- dënohet me të holla, kurse personi përgjegjës i klubit dënohet me ndalesë kohore në kryerjen e detyrës.

### **Neni 79**

Lojtari i cili pa arsye vonohet,refuzon pjesëmarrjen në reprezentacion ose pa arsye nuk paraqitet në përgatitjet e reprezentacionit:

- do të dënohet me ndalesë kohore për lojë,

Nëse deri të vonesa apo mosardhja ka ndodhur me fajin e klubit: klubi dënohet me të holla,kurse personi përgjegjës i klubit me ndalesë kohore në kryerjen e detyrës.

### **Neni 80**

Lojtari ose funksionari i cili merr pjesë në reprezentacion ose në ndeshje ndërkombëtare,me veprimet e veta dëmton autoritetin e sportit të basketbollit:

- dënohet me ndalesë kohore për lojë apo kryerje të detyrës,

Nëse veprimet janë bërë në rrethana rënduese mund të dënohet me ndalesë të përhershme për lojë apo kryerje të detyrës.

Nëse kundërvajtjen e bën klubi-ekipi:

- dënohet me të holla,kurse personi përgjegjës dënohet me ndalesë kohore në kryerjen e detyrës.

### **Neni 81**

Lojtari i cili në afatin kalimtar nënshkruan për dy ose më shumë klube,gjegjësisht lojtari i cili ka nënshkruar më shumë marrëveshje valide me klube të ndryshme:

- dënohet me ndalesë kohore për lojë

Klubi i cili e ka ditur se lojtari i ka dhënë pëlqimin klubit tjetër ,ose që ka marrëveshje të vlefshme me tjetër klub,kurse pranon deklaratën për kalim të lojtarit në klubin e vet,ose nënshkruan marrëveshje me atë lojtar:

- dënohet me të holla,kurse personi përgjegjës dënohet me ndalesë kohore në kryerjen e detyrës.

### **Neni 82**

Klubi i cili inkuadron lojtarin pa kontroll mjekësor,ose nga ana e mjekut i është ndaluar pjesëmarrja:

- dënohet me të holla,kurse personi përgjegjës dënohet me ndalesë kohore në kryerjen e detyrës.

### **Neni 83**

Delegati dhe gjyqtari të cilët me papërgjegjësi, pakujdesi dhe angazhim të pamjaftueshëm e kryen detyrën:

- dënohen me ndalesë kohore në kryerjen e detyrës, ose me të holla.

### **Neni 84**

Delegati ose gjyqtari i cili pa arsye vonohet ose nuk paraqitet në ndeshje:

- dënohet me ndalesë kohore për kryerjen e detyrës, ose me të holla.

### **Neni 85**

Delegati ose gjyqtari i cili tenton të sulmoj fizikisht cilindo pjesëmarrës në ndeshje ose shikues:

- dënohet me ndalesë kohore në kryerjen e detyrës deri në 6 muaj.

### **Neni 86**

Klubi i cili zhvillon ndeshje në Kosove, me ekipe të jashtme, pa pëlqimin e organeve kompetente:

- dënohet me të holla, kurse personi përgjegjës do të dënohet me ndalesë kohore në kryerjen e detyrës.

## **X.-DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

### **Neni 87**

Procedura disiplinore e filluar para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, e cila nuk ka përfunduar në marrjen e vendimit për dënim, do të vazhdohet sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, nëse ato nuk parashohin dënim më të butë për atë kundërvajtje.

### **Neni 88**

Nëse për zhvillimin e procedurës disiplinore para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje ka qenë kompetent organi tjetër disiplinor, vazhdimin e mëtejshëm të procedurës e bënë organi kompetent në këtë rregullore.

### **Neni 89**

Interpretimin e dispozitave të kësaj rregulloreje e bënë bordi i FBK.

### **Neni 90**

Ditën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje bie nga fuqia rregullorja disiplinore e cila ka qenë në fuqi para miratimit të kësaj rregulloreje.

**Neni 91**

Këtë rregullore e ka miratuar kuvendi i FBK në seancën e mbajtur me 6.9.2008, kurse hyn në fuqi 8 ditë nga dita e miratimit.

Sekretari i Përgjithshëm,  
Isuf Lumi

K r y e t a r i,  
Erolld Belegu